



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.323/2026

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.323/2025, të datës 23.03.2026, të parashtruar nga ankuesi N.H, kundër organit të punësimit-Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, në çështjen juridike *“masë disiplinore ndalim prej 20% të pagës për dy muaj”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.323/2026, e datës 23.03.2026, e parashtruar nga ankuesi N.H.

Anulohet Vendimi me numër 510, i datës 13.03.2026, i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike.

Obligohet Sekretari dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil N.H (*referuar tutje ankuesi*), më datë 23.03.2026 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 510, të datës 13.03.2026, të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijs së Ankesave, me datë 27.03.2026, ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit më datë 07.04.2026, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)
administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1443/2026, të datës 23.03.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.03.2026; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 23.03.2026; Vendim me numër protokolli Nr.510, i datës 13.03.2026; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit N.H; Përgjigjen në ankesë të datës 07.04.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Aktin e emërimit të ankuesit N.H me numër Nr.13/2019, i datës 02.10.2019; Përshkrimin e detyrave të punës; Emalin e datës 02.02.2026; Emalin e datës 01.02.2026; Emalin e datës 30.01.2026, me korrespondim prej 3 faqeve; Procesverbalin e datës 23.02.2026; Vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor me numër protokolli Nr.104, të datës 19.01.2026; Akt emërimi A.B, me numër Nr.94/2016, i datës 30.09.2016;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga provat materiale të çështjes Kolegji ka gjetur se ankuesi fillimisht sipas Akt Emërimit me numër protokolli 131/2019 të datës 02.10.2019 mbanë pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor, në Divizionin për Mbikëqyrje dhe Zbatim të Legjislacionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Tutje me datë 29.01.2026 ankuesi në hapësirën e byfes së Ministrisë së Punëve të Brendshme ka kërkuar nga punonjësja e bufësë G.K kafe e cila i ka thënë ankuesit prit pak, ndërsa ankuesi me disa lugë të plastikes ka gjuajt në drejtim të banakut ku disa prej tyre kanë ra në tokë dhe e kanë prek në trup G.K e cila me pas rastin e ka raportuar te Sekretari i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Tutje, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme me datë 01.02.2026 ka kërkuar nga U.D Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme që nëpunësin N.H ta dërgojë në Komision Disiplinor. U.D Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes emalit të datës 02.02.2026 ka kërkuar nga komisioni disiplinor të fillohet procedurë ndaj N.H.

Komisioni disiplinor me datë 23.02.2026 ka mbajtur seancën dëgjimore ku janë dëgjuar dëshmitaret dhe palët, ndërsa me datë 13.03.2026 përmes vendimit me numër protokolli 510 Komisioni disiplinor në Ministrinë e Punëve të Brendshme ankuesit i shqipton masën disiplinore ndalim njëzet për qind (20%) të pagës bazë për dy (2) muaj, me arsyetim, për shkak të shkeljes së detyrave dhe përgjegjësisë të punës, të parapare sipas nenit 56, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 paragrafi 4 nën paragrafi 4.6 dhe 4.7 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtar Publik, si dhe nenit 5 paragrafi 3, nën paragrafi 3.6 dhe 3.7 të Rregullores (QRK) 01/2024 për disiplinën e Nëpunësve Civil.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 510 të datës 23.03.2026 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon se ky vendim është nxjerr në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 4 nën par. 4.2 të rregullores QRK 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, po ashtu i njëjti pretendon se inicimi i procedurës disiplinore

është bërë nga personi jo kompetent, po ashtu nga këshilli kërkon që ti aprovohet ankesa si e bazuar duke anuluar vendimin me numër 510 të datës 13.03.2026 te komisionit disiplinore ne Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoj dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

- Nenit 56, paragrafi 1 dhe 4 me të cilin është përcaktuar se: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1.mospërmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; **4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;** 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.*

-Nenit 57 paragrafi 2 : *“ Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; **2.4. ulja në pozitë;** 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.*

-Nenit 59, paragrafit 2 dhe 3: 2. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil. 3. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrës/it të drejtpërdrejtë të nëpunës/it civil; 3.2. bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e

qytetares/it; 3.3. me nismën e çdo anëtare/i të komisionit, mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e një shkeljeje disiplinore.

Kjo procedurë është iniciuar dhe përfunduar në kuadër të MPB-së, me datë 11.02.2026, Kuvendi i Kosovës ka votuar Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe sipas këtij vendimi është krijuar Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike (kjo Ministri, Më herët ishte Ministria e Administratës Publike), prandaj sipas këtij vendimi edhe personeli i ish MAP është transferuar në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike. Në përgjigjen e datës 07.04.2026 u.d. Udhëheqësi i NJMBNJ në MDAP ka kontestuar vendimin 510 të datës 13.03.2026 dhe ka kërkuar nga KPMSHCK të aprovoj ankesën apo të ndryshoj vendimin në një masë më të letë.

Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë nenin 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shqyrtuar në tersi këtë procedurë disiplinore ndaj ankuesit dhe fillimisht konstaton se procedura disiplinore ndaj ankuesit është iniciuar më datë 02.02.2026 nga Menaxheri i Personelit i Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe nëse i referoheni dispozitës së nenit 59 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Komisioni disiplinor fillon procedurën bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo **zyrtareje/i tjetër brenda institucionit**, si dhe me kërkesën e qytetares/it, mirëpo dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, respektivisht me nenin 7 paragrafi 1, është përcaktuar se: *“1. Nëpunësit civilë të institucionit, kur janë në dijeni apo dyshojnë për shkelje të rëndë të detyrave dhe përgjegjësi, të kryer nga nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, duhet të raportojnë atë me shkrim tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen”*, në këtë rast Sekretari i Përgjithshëm në i MPB ka kërkuar që rasti të dërgohet në Komisionin Disiplinor vetëm me një rresht citoj **“ Ky rast te dërgohet në komision disiplinor. Ndërsa duhet të sigurohemi që pamjet e kamerave ti ka komisioni si dëshmi”**, Sekretari i Përgjithshëm ka qenë i obliguar si ZK ta inicioj vetë procedurën disiplinore dhe të përshkruaj shkeljen e supozuar të ankuesit gjithashtu të klasifikoj shkeljen se a është shkelje e rëndë a po e letë dhe njëkosisht ta informoj edhe mbikëqyrësin e ankuesit. Gjithashtu Menaxheri i Personelit me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka vepruar në kuptim të dispozitës së cekur si më lartë, ngase nuk ka asnjë dëshmi se i njëjti këtë çështje e ka raportuar me shkrim tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në këtë rast i ankuesit, prandaj në bindjen e Kolegjit inicimi i procedurës disiplinore nga SP vetëm me një rresht pa përshkrim të shkeljes së supozuar është shkelje e dispozitave ligjore që rregullojnë disiplinën në shërbimin civil të Kosovës.

Andaj, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA. A.NR.323/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit N.H;
- Organit të punësimit: Sekretarit te Përngjitëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.